

Eficienca e buxhetit të Bashkisë Kurbin (Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	222,031	2,155,641	31%
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	239,721	2,327,388	34%
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	134,549	1,306,301	19%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	108,114	1,049,650	15.2%
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	8,975	87,136	1.3%
TOTALI	713,390	6,926,117	100%

Burimi: Bashkia Kurbin (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Kurbin 2019



Burimi: Bashkia Kurbin (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Kurbin për vitin fiskal 2019

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	226,143	2,195,563	31.7
Shpenzime Korrente	367,568	3,568,621	51.5
Shpenzime për Investime	104,767	1,017,155	14.7
TOTALI	698,478	6,781,340	97.9

Burimi: Bashkia Kurbin (llogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Kurbin (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Kurbin (llogaritje EIC)